



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

### **Nr. 71**

Datë: 25. 10. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

Raport nga QNR-ja.

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **Këshilli për Personel:**

- Shqyrtimi i mundësisë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës të Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv në SKQZ.

#### 4. Të ndryshme.

---

##### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

**Kreshnik Radoniqi:** E hapim mbledhjen e 71-të të KQZ-së sipas rendit të ditës që keni para vetes. Por e kemi edhe Këshillin për Personel, dhe shqyrtimi në këtë këshill do të bëhet me dyer të mbyllura. kemi aktivitetet e sekretariatit me një raport nga QNR ,raportin e këshillave të KQZ-së kemi Këshillin për Personel dhe të ndryshme , a ka dikush diçka me shtu në rend të ditës , në agjendë ?

**Fazli Stollaj:** Për shkak se në mbledhjet e fundit të KQZ-së është potencuar çështja e informimit për raundin e dytë, në fund të mbledhjes e kisha dhënë një njoftim lidhur me Këshillin për Mbikëqyrje të Informimit Publik që është mbajtur sot .

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, nëse pajtohemi me e mbajt informimin para personelit meqenëse, është çështje e hapur. Vazhdojmë me këshillin për personel pas Informimit...

A pajtoheni me këtë rend të ditës ? kush është për ?

Me vota unanime miratohet rendi i ditës

##### 2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

###### Raport nga QNR-ja:

**Burim Ahmetaj :** Të nderuar anëtarë të KQZ-së është duke vazhduar puna në QNR më lejoni të ju njoftoj se me datën 24 tetor ka filluar procesi i numërimit të votave jashtë vendit ku nga numri i pakove të aprovuara prej 9610 fletëvotimeve në kuti të votimit gjatë numërimit të votave jashtë vendit për kryetar komunë janë 9185 fletëvotime të vlefshme dhe për kuvendin komunal janë 9302 fletëvotime të vlefshme pra numërimi i fletëvotimeve jashtë vendit ka përfunduar po të njëjtën datë pra me 24 tetor diku rreth orës 20:00.

QNR pas këtij procesi, ka filluar me procedimin e të dhënave në bazën e të dhënave në mënyrë që këto rezultate të bashkohen me rezultatet përfundimtare për kryetar komune dhe kuvend komunal. Aktualisht, jemi edhe në disa vendvotime për disa komuna të cilat janë në proces e sipër për tu proceduar për

rezultatet e votave jashtë vendit dhe tu bashkohen rezultateve përfundimtare, përndryshe procesi i punës në QNR është duke vazhduar. Jemi të fokusuar në kompletimin e të gjitha aktiviteteve me qëllim që të filloj procesi i verifikimit të votave me kusht proces i cili para se të filloj duhet të sigurohemi që i kemi bazën e të dhënave të gjitha listat përfundimtare të skanuara dhe të përputhura ndërmjet nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve dhe nënshkrime në formularë të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve.

Po ashtu, duhet të sigurohemi që të gjitha votat me kusht të ardhura nga secila komunë e Republikës së Kosovës është e regjistruar në data bazë dhe pastaj do të filloj procesi i kontrollit apo verifikimit të gjithë votuesve që kanë votuar me kusht përkundër votuesve që kanë votuar të rregullt dhe votuesve që kanë votuar jashtë vendit pra votuesit me postë. Kjo bëhet më qëllim që të identifikohen të gjithë votuesit që kanë shfrytëzuar të drejtën të votojnë si votues me kusht dhe me nevoja të veçanta, me qëllim të identifikohen se kanë votuar vetëm njëherë apo kanë shfrytëzuar më shumë të drejta për të votuar.

Në raport, po ashtu janë edhe progresi i procedimit të artikujve për secilën kategori ku së fundi është shtuar edhe procedimi i formularëve të rezultateve të dengut që akronimi apo shkurtesa, është FRD për kryetar komune dhe për kuvendin komunal si dhe FRDK që nënkupton formulari i rezultateve të dengut të votave për kandidat.

Pra, këto dengje krijohen në QNR dhe janë rezultat i numërimit të votave me postë, krahas të gjitha këtyre aktiviteteve QNR gjatë procedimit të materialeve konkretisht formularëve zgjedhorë FPR për kryetar komune FPR për kuvend komunal dhe formularë të rezultateve të kandidatëve një numër të vendvotimeve nuk ka mundur ti procedojë si të rregullta për shkak të mospërputhjeve të të dhënave në formularë të rezultateve , në shumicën e rasteve të formularëve të rezultateve sikur në listë si e keni në tabelën në excel para vetes pra nuk përputhen të dhënat dhe shifrat në formularët e rezultateve pra të dhënat që janë të shënuara në formularë të rezultateve nuk kanë ndonjë kuptim dhe mospërputhja edhe pas hetimit që e kemi bërë është e pashpjegueshme.

Nga lista e vendvotimeve që kanë mospërputhje në shumicën e rasteve, janë formularë të rezultateve për kuvendin komunal dhe një numër i formularëve të përputhjes së rezultateve për kryetar komune , meqenëse kemi të bëjmë me ngatërrim të rubrikave konkretisht është rubrika 3 dhe rubrika 14 pra rubrika 3 në formularë të rezultateve është numri i fletëvotimeve të pranuar dhe rubrika 14 janë të gjitha votimet e hedhura brenda kutisë së votimit në shumicën e rasteve kemi këtë ngatërrim të rubrikave pra përpos ngatërrimit të rubrikave në disa raste si në listë kemi edhe mospërputhje të votave në mes të votave të

subjekteve dhe kandidatëve të gjitha këto janë te pjesa e formularëve të rezultateve për kuvendin komunal.

Si rrjedhojë e kësaj, gjatë hetimit konstatohet se të gjitha këto vendvotime pra formularë të rezultateve të cilat kanë këto mospërputhje që akoma janë të pashpjegueshme për QNR-në nuk mund të procesohen si të tilla dhe rekomandohet KQZ që të gjithë formularët e rezultateve FPR për kryetar komune, FPR për kuvend komunal dhe FRK të vendvotimeve si në listë për shkak të mospërputhjes së të dhënave në FPR ngatërrimi i kategorive të fletëvotimeve në rubrika pra në FPR të cilat edhe pas hetimit janë të pashpjegueshme dhe ka mospërputhje matematikore.

Po ashtu, edhe probleme me vota të subjekteve dhe vota të kandidatëve pra të gjitha këto vendvotime si në listë të rinumërohen pra është fjala për rinumërim të plotë ,kërkojmë falje për një gabim teknik tek prosecimi pra te kolona e fundit në tabelë është të rinumërohen FPR dhe FR mirëpo nënkupton FRK ,pra rekomandimi është që të gjitha këto vendvotime 8 vendvotime për kryetar komune dhe 35 vendvotime për kuvend komunal të ketë rinumërim.

**Arianit Elshani:** Atëherë, unë po e shoh këtë raport të detajuar të gjithë hetimit që është bërë auditimit që është bërë të formularëve të rezultateve të kandidatëve për kryetar komune dhe kuvend komunal dhe kjo ka ardhur si rrjedhojë e gjithë atyre që janë proceduar. Pra, nga vendvotime nga këshillat e vendvotimeve nga KKZ-të në QNR e pastaj në data entry kanë dalur të gjitha këto të gjetura , kam një pyetje lidhur me kërkesën tonë për hetimin e 10 % të flikave se si ka ecur deri tash dhe kur mund të kemi një raport të detajuar të këtij krahasimi të flikave me formularë të rezultateve të kandidatëve sepse gjatë gjithë kësaj kohe pra qe një javë edhe kandidatët për asamble komunale dhe kandidatët për kryetar të komunave janë të interesuar të dinë saktë se çka ka ndodhur në vendvotime. A mund të ketë pasur keqpërdorim dhe manipulim të votave apo, ka shkuar gjithçka ashtu si është kërkuar nga KQZ ?

**Florian Dushi:** Faleminderit për informatat që na i keni sjellur. Ne, ishim dje aty, dhe kishim mundësi me e pa gjatë gjithë ditës zhvillimin e procesit të numërimit të votave të ardhura nga diaspora në Kosovë, dhe mund të them që ju përgëzoj për organizimin e punës. Por ajo që po më intereson, është shqetësim edhe për mua, megjithëse po e shohim raportin e progresit kur afërsisht kemi shpalljen e rezultateve përfundimtare për kryetar komune. Kur llogarisni sipas trendit të zhvillimit të procesve brenda QNR-së por edhe kandidatëve për asamble sepse vërtetë te pjesa e asambleisve ose kandidatëve për asamble, sepse që prej ditës të votimit ata janë në një lloj terri informativ, ndërsa kandidatët për kryetarë sado kudo, kanë pasur rezultatet preliminare. Pra janë këto dy çështje.

Kur llogarisni që ti keni rezultatet e gatshme ? Dhe një çështje tjetër: sa i përket rekomandimit tuaj tek vendimi, nëse nuk e kam lexuar gabim, në paragrafin e dytë është arsyetimi QNR –së që i rekomandon KQZ-së që të gjithë formularët e rezultateve dhe formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultatet për kryetar komune FPR për kryetar të kuvendit FRK, të numërohen.

Megjithatë ndoshta si formulim do të duhej të ishte: “të gjithë formularët që kanë mospërputhje” sepse, kjo kështu po na frikëson në një farë formë...

**Sami Kurteshi**: Unë, bëra përpjekje me pa këtë tabelën me kujdes. Unë, kisha kërkuar si shembull të kësaj tabele që, kanë me shkue në rinumërim...Me na sqarue numrin 25 që, është me numrin më të madh të mospërputhjeve. Janë “292” dhe, është “25” Prishtina...! Me na e e shpjegue pak më në detaje, çka domethënë kjo...Është një dallim jashtëzakonisht i madh kur e dimë ne se vendvotime, përafërsisht janë prej “750” deri “950” votues. S’ka vendvotime më të mëdha ose më të vogla në krejt Kosovën, e dallimi është shumë i madh...

**Alim Rama**: Sa i përket raportit që e përmendi z. Elshani, raporti nga 10 % të verifikimeve kur presim saktësisht që të jetë ky raport por, gjithsesi unë kisha kërkuar që kjo puna e verifikimit nga raporti i “10%” të kutive për Asamble Komunale...mos ta vonojnë përfundimin dhe raportin përfundimtar!

**Florian Dushi**: Meqë, u diskutua edhe raporti nga ky kontrolli i 10 %, a mund të ndodh kryeshef që në fakt pas këtij kontrolli që do ti nënshtrohen eventualisht, se kemi kërkesa shtesë për rinumërim varësisht nga gjetjet...

**Burim Ahmetaj**: Po mundohem të jap shpjegim për secilin çështje që u ngrit këtu. E para, ti referohemi kërkesës së fundit që ka të bëjë me raportin e verifikimit të votave të shënuara në formularë të rezultateve për kandidatë me verifikimin përkundrejt fletave llogaritëse ...Ky proces, është në vazhdim e sipër dhe konsiderojmë besojmë shumë se nesër do ta kemi raportin e të gjitha të gjeturave dhe ky verifikim nuk e pengon fare punën e publikimit të rezultateve për kryetar komune d.m.th., janë dy procese të ndara njëra me tjetrën dhe jemi duke bërë përpjekje që këtë raport ta finalizojmë nesër dhe ta kemi të prezantuar para KQZ-së me të gjitha të gjeturat nga raporti.

Sigurisht që, vendvotimet sikur në listë nëse ndërliiden me rastin që u ngrit te 35 nëse nuk gabo... 25 kërkoj falje tek rasti me numër 25 në të gjitha rastet ka qenë shumë e pashpjegueshme edhe nga ne se nga iu kanë ardhur këto shifra të cilat janë të shënuara në të gjithë formularët e rezultateve d.m.th., i kemi bërë të gjitha hetimet dhe shumica e rasteve ndërliiden me ngatërrim rubrikash apo të dhëna të cilat faktikisht nuk përputhen as me të dhënat e kandidatëve një rast është sikur ky që është pak më ndryshe

prej të gjitha rasteve tjera është që e ka një numër shumë të madh për kuvend komunal ku i kemi numëruar të gjitha votat e alokuara për secilin kandidat dhe nuk korrespondojnë me votat për subjekte.

Votat për subjekte, janë dukshëm më të vogla se sa totali i të gjitha votave për kandidat, shifrat nuk tregojnë që është gjendja e përshkruar reale edhe përkundrejt faktit që në atë vendvotim kanë qenë diku 700 fletëvotime që janë shpërndarë dhe kemi vota të alokuara për kandidat që totali i votave për kandidatë është diku rreth 292 mirëpo mirëpo, në FPR janë shënuar shifra që nuk korrespondojnë fare edhe për neve është shumë e vështirë me i shpjeguar të gjitha këto raste se nga ju kanë ardhur këto shifra që nuk korrespondojnë fare as me numër të fletëvotimeve të lëshuara apo, të pranuar në atë vendvotim nuk korrespondojnë as me fletëvotimet e përdorura dhe ato të papërdorura...

Të gjitha këto kategori, kanë qenë shumë të pashpjegueshme dhe pa u hap kutia e votimit dhe me u numëru me u bë numërim i plotë, ne nuk mund të japim shpjegim se çfarë ka mundur të ndodh dhe cilat kanë qenë ngatërresat sa i përket këtyre vendvotimeve kështu që rinumërimi do të mund të sqaroj gjendjen dhe ta japim edhe shpjegimin pas procesit të rinumërimit të këtyre vendvotimeve...

**Sami Kurteshi**: Një nën pyetje: A janë të gjithë këta formularë të nënshkruara nga të gjithë komisionarë?

**Burim Ahmetaj**: Formularët janë të nënshkruara nga komisionerët dhe janë komisionerët ata që kanë marrë përgjegjësinë me i kriju ato rezultate që po besojmë shumë që kanë dalur prej kutisë së votimit mirëpo nuk e dimë tash pa u bë rinumërimi i plotë sa është gjendja reale e pasqyruar prej formularëve të rezultateve.... prej kutisë së votimit në formularë të rezultateve nëse kam arritur me ju dhënë shpjegim për të gjitha pyetjet që janë bërë ndërsa sa i përket procesve të cilat janë të ndara njëra me tjetrën votat për kryetar komune dhe votat për kuvendin komunal nuk e pengojnë njëra tjetrën për shpallje të rezultateve.

Mirëpo, numërimi i votave me kusht do të bëhet në të njëjtën kohë qoftë për kryetar komune po ashtu, edhe për kuvend komunal sepse, nuk mund ti trajtojmë votat me kusht sepse janë të gjitha brenda një zarfi dhe të gjitha janë një tavolinë edhe do të na duhet aty për aty me krijua rezultate edhe për kryetar komune edhe për asamble.

Ne, jemi duk bërë përpjekje që ti bëjmë të gjitha kontrollet e fundit që të sigurohemi që gjithçka është në data baze, gjithçka përputhet, është me rëndësi që të përputhet edhe numri i nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve ti cilat i kemi skanuar me numrin e nënshkrimeve në formularë të përputhjes se të dhënave dhe rezultateve gjitha kontrollet do ti bëjmë pastaj mund të vazhdohet me verifikimin e të gjithë votuesve me kusht edhe me nevoja te veçanta përkundrejt votuesve të rregullt dhe votuesve me

postë dhe pastaj mund të fillojë procesi i numërimit të votave me kusht ,nëse kam mbetur ndonjë pyetje pa ju përgjigj ju lutem ...

**Arianit Elshani**: Lidhur me këto vendvotime të cilat do të shkojnë në rinumërim duke e ditë si e kemi paraparë që të shkoni se, disa të gjetura janë vetëm për subjekte specifike, pra bëhet fjalë për ndonjë subjekt që ka mospërputhje të të dhënave pra, a do të kemi rinumërim të plotë të asaj kutie për çdo subjekt sepse mendoj që është më e lehtë ? Ta heqim barrën edhe në qoftë se ka ankesa, pastaj në PZAP lidhur me rezultatet përfundimtare pra, që një kuti kur te hapet të rinumërohet në tërësi për çdo subjekt politik. Kjo është kërkesa që mendoj se vërtetë do të na lehtësonte neve punën pas publikimit të rezultateve.

Pra, këtë pyetje edhe tjetra, është lidhur me kërkesën e z. Rama që pat në raport me krahasimin me votat me listën votuese dhe me votat e kandidatëve për kryetar komune! Këtu mendoj që rrezikojmë të vendosim dy standarde: e para është mirë që sa më shpejtë të vie raporti i hetimit të 10 përqindëshit të flikave të krahasimit për shkak që rrezikojmë të vendosim dy standarde pra për këto kuti të cilat po rinumërojmë tash marrim vendim që të krahasohen me listën votuese dhe listën e nënshkrimeve ndërsa, e dyta, në raport me ato që do të hetohen të 10 përqindëshit të mos i krahasojmë me listëve e nënshkrimeve pra të vendoset një standard që secila kuti që hapet të krahasohet me listën e nënshkrimeve dhe edhe ato që dalin nga ai 10 përqindësh norma e 10 përqindëshit të cilën ne këtu si përbërje e kemi miratuar në mënyrë që të rritet transparencja, në mënyrë që të kemi një filtër shtesë të kontrollit në raport me zgjedhjet e kaluara.

Kjo, nuk ka ndodhur pra për herë të parë kemi vendosur një standard ku do ti filtrojmë edhe njëherë pra të gjitha ato flika ti krahasojmë me rezultatet përfundimtare në mënyrë që të dimë qartë se nuk është prekur ,nuk është devijuar ai vullnet i qytetarëve që është shprehur në kutitë e votimit pra këtë pyetje vetëm sa i përket rinumërimit a do të kemi rinumërim të plotë të asaj kutie .

**Florian Dushi**: Tash, afërsisht po e kuptojmë që jemi në fazën finale para shpalljes së rezultateve që nënkupton përveç këtyre rinumërimeve i kemi edhe votat me kusht dhe votat e personave me nevoja të veçanta prandaj po më intereson me ditë a ka filluar regjistrimi i këtyre votave në njërën anë, eventualisht verifikimi i tyre ta dimë sa kemi në total vota ose ndaras nëpër komuna të atyre që janë konfirmuar nëse veç i janë nënshtruar këtij procesi...

**Sami Kurteshi**: Faleminderit për fjalën , unë e kam edhe një rast konkret është numër 15 në këtë regjistrin e këtyre vendvotimeve që do të numërohen është Podujeva , sqarimi është ky pas llogaritjeve

matematikore dallimi mes rubrikës 3 dhe 14 është 127 ,fletëvotime të pranuar janë 650 ndërsa pas llogaritjes janë gjithsej 776 fletëvotime tash nuk e kam të qartë fletëvotime të pranuar nga këshilli i vendvotimit apo kush i ka pranuar ,kur i kanë pranuar këto fletëvotime edhe si kanë dalur 776 fletëvotime edhe e dyta a është verifikuar se, a i takojnë ato fletëvotime se meqenëse e kanë atë kodin krejt të atij vendvotimi...

**Burim Ahmetaj:** Po, mundohet të jap shpjegim prej këtyre më të fundit , po ndërlidhem me tabelën që është para jush jemi bazuar në të dhënat që janë të shënuara në formularë të rezultateve kutinë nuk e kemi qelur kështu që nuk e dimë si e kemi situatën , të dhënat na tregojnë që i kemi 776 fletëvotime nuk e dimë as ku e kanë marrë këtë përputhje apo këtë matematikë që e kanë bërë mirëpo kur të hapet kutia atëherë do ta shohim saktë se sa fletëvotime këtu raporti thotë se i kanë pranuar 650 fletëvotime dhe prej këtyre 650-ve, duhet të jenë një kategori fletëvotime të përdorura dhe ato të papërdorura edhe këto të dyja duhet të përputhen mes vete.

Fletëvotime e përdorura pastaj, i kanë fletëvotimet e zbrazëta, fletëvotime të pavlefshme dhe fletëvotime të vlefshme të cilat shpërndahen vota për secilin kandidat kështu që pa hapur kutinë është shumë e pashpjegueshme për neve edhe me ardhur në konkluzion se nga iu ka ardhur kjo shifër që kanë qenë totalisht të pashpjegueshme për neve do të thotë për këtë arsye po ndërlidhem edhe me kërkesën e z. Elshani që kërkojmë të bëhet rinumërim i plotë për të gjitha rastet në mënyrë që të qartësohet dhe të dalë situata ashtu me fletëvotime se si janë brenda kutisë së votimit dhe të krijohen formularë të ri të cilët do të krijohen në QNR dhe pastaj këto formularë të rezultateve të përfshihen në rezultate përfundimtare kështu që rekomandimi është që të bëhet rinumërimi i plotë ndërsa sa i përket votave me kusht sipas të dhënave preliminare i kemi diku rreth 12 mijë vota me kusht mirëpo raportin më të detajshëm do tua sjell sot dikur gjatë ditës dhe atëherë do ta dimë për secilën komunë se sa vota me kusht .....

Dhe, jemi duke i bërë kontrollet e fundit në mënyrë që të kemi saktë se secila votë me kusht që është hedhur që është pranuar nga KQZ gjatë pranimit në QNR të jetë në regjistër pastaj kur të kompletohet gjithë ky proces do të bëhet krahasimi mes votuesve të rregullt dhe votuesve me postë dhe do ta kemi final raportin vetëm votat të cilat konfirmohen do të numërohen në QNR kështu që janë shumë kontrolle te cilat duhet ti bëjmë në mënyrë që të jemi 100 % sigurte se janë të dhënat e sakta ndërsa sa i përket raportit të 10 përqindëshit të hetimit apo verifikimit të rezultateve me formularë të rezultateve të kandidatëve përkundrejt fletave llogaritëse të kandidatëve në këtë fazë nuk e bëjmë krahasimin me numrin e nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve, ajo çka është detyrë e QNR-së është ti krahasoj të gjitha votat që janë të shënuara në FRK me rezultatet që janë në fletat llogaritëse po ashtu



QNR ka për detyrë me i kontrollu të gjitha vijat që secila vijë nënkupton një votë në fletë llogaritëse të kandidatëve dhe në fund totalin në fletë llogaritëse të kandidatëve.

Ky total do të krahasohet me totalin e formularëve të rezultateve të kandidatëve dhe aty e dimë saktë nëse nuk janë shënuar saktë apo kemi të bëjmë me gabime njerëzore që mund edhe të jenë gabime njerëzore apo kemi të bëjmë me gabime të qëllimshme kështu që kur te përfundojmë edhe raportin do ta sjellim në detaje dhe do ta pasqyrojë të gjithë gjendjen pra këto vendvotime janë në bazë të metodës të rastësishme të gjitha ato vendvotime që janë rinumëruar dhe do të rinumërohen ndoshta do të jenë aty edhe në verifikim kështu që nuk e dimë akoma se a janë pjesë e asaj metode të rastësishme apo nuk janë ... mirëpo raportin kur te sjellim ...

Metoda e rastësishme, është bërë shumë ditë para ditës së zgjedhjeve edhe nuk i kemi paragjykoa se cili vendvotim duhet të jetë në atë listë apo jo kështu që kjo listë është bërë më herët do ta ndajmë veç edhe do ti dërgojmë sigurisht që dihet situata edhe pas rinumërimit që me të vërtetë ka pasur problem edhe do ta bëjmë një pjesë të veçantë të raportit mirëpo nuk e kemi paragjykoa sipas metodës së rastësishme se cili vendvotim duhet me qenë në atë listë e cila është bërë para ditës së zgjedhjeve dhe s'kemi ditur a ka me pas problem ai vendvotim apo s'ka me pas problem .

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë nëse nuk ka dikush diçka tjetër unë e hedh në votim rekomandimin pra nga QNR. Kush është për miratimin e rekomandimit të QNR-së ?

Me vota unanime, miratohet rekomandimi nga QNR për rinumërim të plotë të listës të kutive të votimit të parashtruar nga sekretariati.

Urdhëro Burim ?

**Burim Ahmetaj**: Lidhur me procesin e rinumërimit, do ti njoftojmë të gjitha subjektet politike për kohën kur do të fillojë dhe koha kur do të filloj procesi i rinumërimit është ora 17:00 sot në QNR , sot prej këtyre 8 vendvotimeve për kryetar të komunës dhe 35 për asamble komunale , për këtë do ti njoftojmë të gjitha subjektet politike dhe vëzhguesit dhe të gjitha palët e interesuara ta përcjellin këtë proces

### **3.Raport i Këshillit Mbikëqyrës të Informimit Publik**

**Fazli Stollaj**: Për shkak se këtu është parë e rëndësishme të ketë informim lidhur me raundin e dytë që do të mbahet mirëpo, është paraparë edhe me planin operacional, atëherë Këshilli për Mbikëqyrje të

Informimit Publik sot paradite, është mbledhur edhe ka shqyrtuar tekstin i cili do të shërbejë për të krijuar video dhe audio spote të cilat do ti informojnë votuesit të cilët do të votojnë jashtë Kosovës të cilët, janë regjistruar suksesshëm për votim jashtë vendit dhe video dhe radio spote të cilët do të jetë për votim brenda vendit që ka të bëjë me raundin e dytë d.m.th., këto do të jenë informata për afatet se kur është afati për votim si dhe udhëzimet se si të votohet.

Ky, ishte një njoftim i shkurtër nga Këshilli për Mbikëqyrje të Informimit Publik...

**Kreshnik Radoniqi**: Nëse nuk ka dikush diçka, unë e kisha bërë një pauzë 5 minutëshe dhe kishim vazhduar me pikën e radhës të Këshillit për Personel në mbledhje të mbyllur...

**Të ndryshme !**